



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.184/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së shtandit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.184/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – vendosja e shtandit njoftues me slogane të subjektit politik, për fushatën zgjedhore në rrugë publike – shesh, në Komunën e Prishtinës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 2,300.00 (dy mijë e treqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, Lëvizja Vetëvendosje, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 02.10.2019 rreth orës 15:15, në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë, kanë vërejtur një “Shtand” të vendosur nga aktivistët e AAK&PSD, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Si dëshmi ankesës i kanë bashkangjitur fotografitë në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, koalicioni AAK&PSD, deklaroi se vendosja e këtij shtandi është bërë për një periudhë kohore prej dy orëve e lajmëruar në KKZ, nga kandidati në fjalë Yll Bogaj i cili ka pasur një takim me qytetar të një kafiteri në afërsi të këtij shtandi, dhe me të përfunduar takimi është larguar edhe shtandi në fjalë. Më tutje në përgjigje koalicioni AAK&PSD, theksojnë se kanë marrë masa përmirësuese duke e hequr shtandin, por të njëjtit nuk kanë bashkangjitur asnjë provë për vërtetimin e këtij pretendimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LPZ-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se shtandi me materialet zgjedhore të koalicionit AAK&PSD, është i vendosur në rrugë publike pëkatësisht në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se koalicioni AAK&PSD, me seli në Prishtinë, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se shtandi i vendosur në rrugë publike, ku

paraqet veprim të sanksionuar me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë të kualicionit AAK&PSD, se vendosja e këtij shtandi është bërë për një periudhë kohore prej dy orëve e lajmëruar në KKZ, nga kandidati në fjalë Yll Bogaj i cili ka pasur një takim me qytetar të një kafiteri në afërsi të këtij shtandi, dhe me të përfunduar takimi është larguar edhe shtandi në fjalë, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto thënie nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuar politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e të dy subjekteve në fjalë në zgjedhjet e mëparshme, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë kualicioni në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë kualicioni prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Paneli zgjedhor me rastin e shqiptimit të lartësisë së gjobës mori për bazë deklarinë në përgjigje të subjektit ndaj të clit është paraqitur ankesa se leja për shtand ka qenë 2 orë, andaj vlerëson se pas kësaj kohe shtandi ka qenë i larguar edhe pse një gjëgtë tillë me provë konkrete nuk e vërtetoi subjekti në fjalë.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.184/2019 më datën 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Faton Ademi

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.

